A.K.P.A.
Nr 508 Prot.
Datë,më 23.02.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA MEKANIKE BUJQËSORE "HASAN D. GINA" LUSHNJË

Nr. 141 prot.

Lushnjë më .22.02.2024

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
**DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**
**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së.shkolla mekanike bujqësore "Hasan D. Gina" Lushnje, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

**Mesimdhenes i teorise profesionale Dega Teknologji Informacioni e Komunikimi (T.I.K) (me kohe te plote )**

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vend te lire si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

**2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a. letërmotivimin për pozicionin;
b. jetëshkrimin (CV-në);
c. kartën e identitetit;
d. diplomën;
e. librezën e punës;
f. çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV-ne;
g. certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j. vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 04.03.2024

DREJTORI I SHKOLLES

Ardjan Prifti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHKOLLA MEKANIKE BUJQËSORE "HASAN I DIGINAI" TIRANË